



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 19 DHJETOR 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
19. DECEMBRA 2008. GODINE**

**DHJETOR – DECEMBAR
2008**

Më 19.12.2008, ora 10:00

Drejttoi seancën: Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT:

Të nderuar deputetë,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës së sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 88 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Fillojmë me rendin e ditës që e kemi në shqyrtim:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2009**

Miratimi në parim i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2009 është bërë më 25 nëntor 2008.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Raporti i Komisionit për Buxhet dhe Financa iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetin Gani Koci, që para deputetëve ta prezantojë raportin, me rekomandime. Urdhëro, e ke fjalën!

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më shumë se një muaj është marrë me Projektbuxhetin për vitin 2009, të propozuar nga Qeveria dhe dje e ka përfunduar punën e vet dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me amendamentet. Paraprakisht dua të falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa për angazhimin e tyre maksimal, po them, 30 - ditorë. Dua të falënderoj edhe për kontributin e dhënë në Komision, një kontribut mjaft i çmuar dhe për konstruktivitetin gati në çdo pjesë që është diskutuar buxheti dhe që është ndryshuar eventalisht dhe që është paraqitur në amendamente. Pra, të gjitha këto amendamente që i ka propozuar Komisioni për Buxhet, kanë pasur një pajtueshmëri, po them, gati të përgjithshme në Komision dhe në shumë prej tyre ka pasur edhe koncensus të plotë, prandaj konsideroj dhe i ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që t'i miratojnë amendamentet e propozuara në Projektbuxhetin për vitin 2009.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Vazhdojmë me votimin e amendamentit të parë.

Kemi hyrë në procedurën e votimit. Vazhdojmë me votim.

Kemi hyrë në rend të ditës, ju lutem. Një pikë të rendit të ditës e keni.

Kryeministër, kemi hyrë në procedurën e votimit. Meqe ka deputetë që e kanë kërkuar fjalën, ju kisha lutur të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të ligjit që e kemi në rend të ditës.

Një pikë e rendit të ditës, kemi filluar rendin e ditës dhe për sot harroni, veç mund të fillojmë seancë të re. Në parim, kem diskutuar për buxhetin, komisionet parlamentare kanë punuar për buxhetin. Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision kryesor, ka paraqitur rekomandimet. Kemi hyrë në procedurën e votimit. Votojmë.

Amendamenti 1.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për të votuar. Votojmë tash:

Ju, do të thotë, jeni “për” a për çka? Kush është “për” që voton me dorë, por që s’ka votuar, s’ka kartelë. A ka “kundër” pa kartelë? Një.

Konstatohet se me 67 vota “për”, 18 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 72 vota “për”, 17 “kundër” dhe 8 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota “për”, 18 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Regjia, përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 18 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 19 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 16 “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, 20 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Në sallë janë 102 deputetë.

Konstatohet se me 71 vota “për”, 21 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, 19 “kundër” dhe 9 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, 22 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, 23 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, 19 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, 25 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 70 vota “për”, 23 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 14.
Ky amendament duhet të standardizohet sikur të gjitha ligjet e tjera.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 72 vota “për”, 22 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, 23 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 21 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, 23 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, 22 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Urdhëro, Sabri!

SABRI HAMITI: Unë kam dy- tri vërejtje dhe fjalë për amendamentin 20, sepse këtu kemi të bëjmë me lëvizjet që kanë ndodhur, kërkesat dhe korrigjimet te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Më së pari, buxheti për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është buxhet shumë i vogël, jashtëzakonisht i vogël bëhet edhe më tepër buxheti për kulturën edhe më i vogël bëhet ky buxhet kur kemi të bëjmë me pjesën që ka të bëjë me atë që quhet, financim i qartë i veprimtarisë kulturore- krijuese. Meqë, unë e di që tash kjo kornizë e shumave është krijuar tash për tash, unë propozoj që nga dy rubrikat që ekzistojnë këtu- Përkrahja institucioneve për kulturë, që nënkupton atë që është kulturë e institucionit, që ne e quajmë "elitare" dhe përkrahja e kulturës, që ka të bëjë me iniciativat më të vogla dhe, hajt, po e quaj kushtimisht "popullore", të bëhet një ndryshim, sepse në rubrikën e parë, nga 1 milion e 540 mijë, mbi 600 mijë shkojnë për paga. Pra, e thërras ministrin e Kulturës, edhe Kryeministri është këtu, që nga rubrika e fundit - Përkrahja e kulturës, të kalohet një shumë te rubrika - Përkrahje institucioneve të kulturës, dhe të njëjtën kohë të thuhet që "Ministria financon 400 mijë euro për film dhe 350 mijë euro për teatër." Unë kam biseduar edhe me Komisionin gjegjës, kërkoj që të sqarohet ministri, pastaj edhe Komisioni. Faleminderit!

Ndërsa, meqë e mora fjalën këtu, dhe puna e Akademisë nuk është institucion që bie në ministri, e ministritë si duket e kanë harruar këtë, sepse nuk bie në resorë të tyre. Ju them që buxheti i Akademisë është i njëjti që katër vjet. Ai veç është përshkruar, është gabim, sepse edhe përbërja, edhe numri ka ndryshuar, edhe kërkesat kanë ndryshuar. Nëse sot s'mund të bëhet gjë, zoti ministër i Financave, atëherë gjeni mundësinë në rishikim, sepse do ta rishikoni, domosdo, sepse llogaria është bërë para zgjedhjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kërkoj deklarin e kryetarit të Komisionit.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ky është një rregullim i brendshëm i buxhetit në linjën buxhetore që ka kërkuar zoti Sabri Hamiti, në këtë rast. Ne në Komision të Buxhetit nuk kemi mund, kemi pasur një kërkesë, por s'kemi pasur kërkesa të adresuara me shkrim, vetëm biseda. Pra, ne nuk kemi mund ta dimë se këto mjete që destinohen si përkrahje institucioneve të kulturës, ku mund t'i destinojë Ministria përkatëse, prandaj në këtë rast, në qoftë se Ministria përkatëse di të bëjë këtë ndarje sipas kërkesës së deputetit, në strukturën e buxhetit nuk prish asgjë absolutisht dhe nuk e prish strukturën, tërësinë e buxhetit. Prandaj, le të deklarohet ministri i Kulturës se në cilat shuma nga kjo linjë buxhetore, për të cilat programe ose projekte mund t'i ndajë dhe ajo të jetë si pjesë plotësuese e këtij amendamenti?

MINISTRI VALTON BEQIRI: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Meqë u kërkuua fjala nga unë, natyrisht e kam për obligim t'ju them se ne nuk kemi kërkuar vetëm me fjalë, por edhe me shkrim, edhe zyrtarisht, një shtesë prej diku 1 milion e 300 mijë euro për kodin buxhetor të subvencioneve, pra ku subvencionohen institucionet e kulturës dhe të gjitha aktivitetet e tjera kulturore. Megjithatë, unë, në parim pajtohem që ta realizojmë këtë bartje, meqë kjo është bartje, e cila realizohet përbrenda

Ministrisë, por meqë kërkohet edhe publikisht, unë e pranoj, sepse jam i interesuar që bashkë me ju t'u japim sa më shumë përkrahje aktiviteteve kulturore. Por, po ashtu kërkoj, njëkohësisht, që në rishikim të buxhetit kjo shumë, e cila është ridestinuuar, të mbulohet nga ju dhe nga të gjithë të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: Ardian, nëse e ke fjalën për amendament, urdhëro!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Po, s' kam për çka tjetër ta kem fjalën, por edhe për amendamentet diskutohet, se dikush mund të kërkojë të mos votohen. Shembull ta marrim, kanë të drejtë deputetët të flasin për amendamente, për secilin amendament. Po, ajo çka po dua të them unë tash këtu, është befasi me të vërtetë e paparashikueshme, kur ende pa u miratuar ky buxhet, e procesi buxhetor ka zgjatur 6 muaj, flitet për rishikim. A është dikush duke e kuptuar çka do me thënë kjo, kur në ditën kur duhet të miratohet buxheti, që është punuar për 6 muaj, filloni të flisni për rishikim! Mendoj se është kulmi i një papërgjegjësie, kulmi i një padije. Kjo është ekstreme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ke të drejtë të thuash edhe ashtu!

Votojmë amendamentin e Komisionit. Gani Koci e ka fjalën. Urdhëro!

GANI KOCI: Zoti Kryetar,

Këtu propozimi nuk ishte në kuptimin e asaj, i qartë, i shkruar, prandaj, unë kërkoj që ky amendament, pra, të mbetet me kërkesën e Kuvendit që të plotësohet nga Komisioni para së të përfundojë votimi i buxhetit në tërësi.

KRYETARI: Ju lutem, atëherë i mbetet Ministrisë që ta bëjë ndarjen, ne votojmë amendamentin 20.

Amendamenti 20.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota "për", 20 "kundër" dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota "për", 20 "kundër" dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota "për", 21 "kundër" dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 votë "për", 22 "kundër" dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota "për", 22 "kundër" dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 20 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, 19 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota “për”, 18 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota “për”, 19 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 73 vota “për”, 18 kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 72 vota “për”, 18 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Votojmë tash:

Regjia, elektronika është në defekt.

(Ndërprerje incizimi)

Vazhdojmë me procedurën e votimit.

Në radhë është amendamenti 31.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 69 vota “për”, 19 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, 19 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 votë “për”, 16 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Në radhë është amendamenti i fundit.

Amendamenti 34.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 72 vota “për”, 16 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 34.

Tani është radha për ta votuar Ligjin në tërësi, me amendamentet që i votuam.

Regjia, përgatitet për votim. Votojmë tash:

Në sallë janë 100 deputetë.

Konstatohet se me 74 vota “për”, 21 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet Ligji i buxhetit për vitin 2009.

(Duartrokitje)

Zoti Kryeministër, më herët e keni kërkuar fjalën, urdhëroni!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar Kryetar i Kuvendit, z.Krasniqi,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të Kosovës,

Sot bashkërisht shënuam edhe një hap përpara për shtetin tonë dhe qytetarët e Kosovës dhe nëse dikush ka menduar se ne nuk mund të jemi në gjendje të punojmë së bashku në mënyrë demokratike për çështje që janë të rëndësishme për shtetin tonë, ky buxhet dëshmon të kundërtën. Bashkërisht po i ndërtojmë kapacitetet tona shtetformuese, së bashku ne përgatitëm një buxhet të drejtë dhe të balancuar, i cili do të jetë në shërbim dhe të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës. Së bashku, ne e përgatitëm një buxhet që do të shërbejë si bazament për një Kosovë të përparuar dhe të suksesshme. Së bashku ne posa votuam buxhetin e parë të Republikës së Pavarur të Kosovës. Ky është moment i shënuar në historinë tonë. Buxheti i vitit 2009 është buxhet i zhvillimit ekonomik të Kosovës. Gjatë përgatitjes së këtij buxheti, me kujdesin më të madh ne dëgjuam zërin e kërkesave të arsyeshme të qytetarëve të Kosovës. Ne të gjithë duam stabilitet, përparim dhe zhvillim ekonomik. Të gjithë duam shtet me resurse të mjaftueshme për t’i mbrojtur të gjithë qytetarët tanë. Të gjithë duam shtet që ofron shpresë, mundësi të barabarta për të gjithë.

Ndërsa, Qeveria e Republikës së Kosovës është e zotuar se do t’i ndjekë këto qëllime si prioritetet tona shtetërore. Ky buxhet është një hap i madh përpara drejt këtij synimi, të cilin do ta realizojmë së bashku. Qeveria zotohet për forcimin e betejës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, do të ketë zero tolerancë ndaj dukurive negative.

Gjatë vitit 2009 Kosova do të shpenzojë buxhete për investime kapitale: në arsim, shëndetësi, infrastrukturë rrugore, bujqësi, mirëqenie sociale dhe programe tjera për qytetarët e Kosovës dhe thellimin e reformave në të gjitha drejtimit: në ekonomi, legjislacion dhe aspekte të tjera. Do të krijohen vende të reja të punës, pagat do të vazhdojnë të rriten në sektorë të ndryshëm. Mbi të gjitha, fëmijët tanë do t’i përgatisim për të konkurruar në tregun global të punës.

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Kosovës,

Më lejoni që t'ju falënderoj të gjithëve për besimin dhe mbështetjen që po ia jepni Qeverisë së Republikës së Kosovës, të gjitha partitë politike, për mbështetjen edhe të opozitës, të organizatave joqeveritare, mediave për prezantim dhe për opinionet e tyre. Ne po punojmë çdo ditë për ta forcuar qeverisjen e mirë, transparente dhe demokratike, ashtu siç e meritojnë qytetarët tanë dhe kjo punë më bën që sot të ndihem krenar dhe i përgjegjshëm me të arriturat tona të përbashkëta dhe të mos harrojmë se ky është vetëm fillimi.

Dua ta falënderoj këtu ministrin dhe zëvendësministrin e Ekonomisë dhe të Financave dhe gjithë stafin e Qeverisë që kanë punuar në përpilimin e këtij buxheti. Ndhem krenar me punën e secilit ministër deri tani, mbi të gjitha ndihem shumë krenar me gjithë personelin e administratës publike. Unë dua të besoj se kështu do të vazhdojmë të punojmë edhe në të ardhmen.

Gjatë përpilimit të buxhetit kam kërkuar nga të gjithë që t'i kenë parasysh nevojat dhe kërkesat e çdo qytetari të Kosovës. Kam kërkuar që të merret parasysh kriza globale financiare dhe të gjenden mënyra për ta mbrojtur qytetarin nga ndikimi i saj.

Ky proces kërkon syçelëti, analizë të plotë dhe vendime të vështira, të drejta dhe në kohë të duhur. Ne kemi punuar së bashku për të garantuar që çdo cent të shkojë aty ku duhet, për çdo cent do të ketë llogaridhënie. Jam i kënaqur që për këtë kemi punuar të gjithë jo si politikanë, jo si anëtarë vetëm të partive politike, por si qytetarë- shtetas të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Me këtë ne i kemi treguar popullit të Kosovës, u kemi treguar partnerëve tanë ndërkombëtarë se demokracia, liria dhe zhvillimi mund dhe janë duke shënuar rezultate në Kosovë.

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ju falënderoj për besimin, për votën tuaj. Miratimi i këtij buxheti është hap më vendimtar në rrugën e Kosovës për konsolidimin e shtetësisë së vet. Si parlamentarë të shtetit tonë, ju me votën tuaj "pro" këtij buxheti dëshmuat se jeni përfaqësues të zërit të qytetarëve.

I nderuar, zoti Krasniqi, Kryetar i Parlamentit,

Ju falënderoj për kontributin tuaj, për krijimin e kushteve për një debat dhe votim konstruktiv mbështetës.

Partnerëve, miqve dhe këshilltarëve tanë ndërkombëtarë iu faleminderit në emër të Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës. Ju punuat me ne për pavarësinë e Kosovës, tani po na ndihmoni për të bërë Kosovën të barabartë, të zhvilluar dhe të integruar në bashkësinë ndërkombëtare. Kosova do të vazhdojë ta arsyetojë investimin dhe besimin tuaj në ne. Brezat që do të vinë pas, do ta kujtojnë këtë moment, do t'i studiojnë të arriturat tona dhe do të na falënderojnë të gjithëve, pa dallim, sepse do të shohin se buxheti i parë i shtetit të Kosovës së pavarur është bazament i tyre për të ardhmen. Ju faleminderit!

I nderuar, zoti Kryetar, para se të largohem, do të prezantoja edhe një çështje që mendoj se është me interes për plotësimin e funksionimit të institucioneve të shtetit të Kosovës, funksionalizimit më të mirë.

Do të dëshiroja që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, se ashtu, siç është edhe e ditur, dje është shtyrë për seancën e ardhshme çështja e Ligjit për Presidentin. Ju e dini se kjo çështje ka qenë në rend të ditës dje, ka kaluar leximi i parë. Ky ligj është i sponsorizuar nga Qeveria e Kosovës. Deputetët kanë kërkuar që kjo çështje të shtyhet për një seancë tjetër, por që të mos e humbasim një muaj e më tepër, por që është edhe e nevojshme, ne e vlerësojmë dhe besojmë për këtë arsye edhe e kemi sponsorizuar. Mendojmë se Qeveria konsideron se Ligji për Presidentin ka qenë në lexim të parë, edhe tani në lexim të dytë, si procedurë e rregullt plotësisht demokratike. Po ashtu, edhe ju të nderuar deputetë, shumica nuk keni pasur asgjë kundër në përmbajtjen e tij, prandaj ne propozojmë që Ligji për Presidentin të hyjë sot në rend të ditës, të deklarohet Parlamenti, të kemi një pauzë të shkurtër dhe ju ftoj të gjithëve, pa dallim partie, për forcimin dhe plotësimin e funksionalizimit të institucioneve shtetërore të Kosovës, që të votoni për futjen në rend dite të kësaj pike dhe të votohet. Natyrisht se do të kemi edhe ligje të tjera që janë në pritje, por do t'i vijë radha secilit ligj që të aprovohet. Besoj se kjo është zgjidhje që i përkon ndërtimit të bazës legale dhe trajtimit shtetëror të institucioneve dhe të bartësve të tyre dhe së fillon me kompletimin nga ky legjislacion.

Prandaj, do të kërkoja që të krijohet një mundësi legale që të deklarohet Parlamenti pas një pauze të shkurtër apo siç e shihni ju, zoti Kryetar, më të përshtatshme, më adekuate apo drejtpërdrejt, siç e vlerësoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër për deklaratën! Falënderoj edhe deputetët, vërtet, për prezencën meritore sot në këtë seancë të rëndësishme për buxhetin e Kosovës.

Dëgjuat kërkesën e Kryeministrit dhe, me Rregullore, Kryeministri ka të drejtë të thërrasë seancë të re, po megjithatë, pasi jemi në seancë, mund të kërkojmë një prononcim të shefave të grupeve parlamentare për seancë të re, se kjo seancë mori fund. Gjithnjë për seancë të re le të deklarohen shefat e grupeve parlamentare dhe pastaj mbi bazën e atij deklarimi ne e marrim një pauzë për të vazhduar seancën e re pas një pauze prej 30 minutash.

Mirë, atëherë kush është “për”? Sekretaria numëroni votat! Faleminderit! Kush është “kundër”? Do të thotë, 4 vota janë “kundër”. Pra, me shumicën absolute shkojmë në seancë të re pas 30 minutash.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve